



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 11 / 015

Datë 01 / 07 / 2020

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson: Muhadin Halili , Drejtor i Prokurimit në njërën anë:

dhe

N.P.T. „ Ellicana,, nga Rahoveci që e përfaqëson **Z.Mizahir Cana** nr. i tel.044-372-001 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizim me Veshembathje për Institucionet e Komunës së Shtimes

Nr i Prokurimit 617-20-2608-1-3-6

Nr i brendshëm 617-2020-026-136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë

Furnizim me Veshembathje për Institucionet e Komunës së Shtimes

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 01.07.2020 dhe përfundon me 01.09.2020

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 130 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë : *Institucionet e cekura në paramasë.*

1.5 Incotermini i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 1,110.00 €
(Njëmijë e njëqindë e dhjetë euro)

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimi të secilës dërgesë (Faturë) nga OE, dhe raporti i Menaxherit të Kontratës të caktuar nga AK për furnizimin e kryer .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për NA

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është

nënshtruar një gjykim që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.


Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Mizahir Cana	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.07.2020	Data:	01.07.2020
Vula:		Vula:	

Specifikacion:Furnizim me Veshembathje per Institucionet e Komunes së Shtimes,Drejtora për Shërbime Publike

NR	PËRSHKRIMI	NJISIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
1	Kate rrobash (setër dhe pantolla).Numrat: (2 x 52, 1 x 54, 1 x 62) Ose ekuivalent	Copë	4	45.00	180.00
2	Këmisha me krahe të shurtër me material prej pambuku Numrat: (1 x M, 2 x XL, 1 x XXL.) Ose ekuivalent	Copë	4	10.00	40.00
3	Këpuce elegante Numrat: (3 x 42, 1 x 45) Ose ekuivalent	Copë	4	23.00	92.00
4	Kate rrobash për femra (setër dhe pantolla).Numrat: 36 Ose ekuivalent	Copë	1	45.00	45.00
5	Këpuce të femrave për dimër Numrat:38 Ose ekuivalent	Copë	1	25.00	25.00
				Totali:	382.00



Specifikacion:Furnizim me Veshembathje per Institucionet e Komunes së Shtimes,Drejtora për Ekonomi Zhvillim-Njësia e Pylltarisë

NR	PËRSHKRIMI	NJISIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
1	Pantolla (nr 50, sezona ver)	Copë	1	12.00	12.00
2	Këmisha (nr 41 sezona ver)	Copë	1	10.00	10.00
3	Pallto (nr 52 sezona ver)	Copë	1	15.00	15.00
4	Këpuce (nr 41 sezona ver)	Copë	1	23.00	23.00
5	Pantolla (nr 56. sezona ver)	Copë	1	12.00	12.00
6	Këmisha (nr 44 sezona ver)	Copë	1	10.00	10.00
7	Pallto (nr 56 sezona ver)	Copë	1	15.00	15.00
8	Këpuce (nr 44 sezona ver)	Copë	1	23.00	23.00
9	Pantolla (nr 56. sezona dimer)	Copë	1	12.00	12.00
10	Këmisha (nr 44 sezona dimer)	Copë	1	10.00	10.00
11	Pallto (nr 56 sezona dimer)	Copë	1	15.00	15.00
12	Këpuce (nr 44 sezona dimer)	Copë	1	23.00	23.00
13	Pantolla (nr 50, sezona dimer)	Copë	1	12.00	12.00
14	Këmisha (nr 41 sezona dimer)	Copë	1	10.00	10.00
15	Pallto (nr 50 sezona dimer)	Copë	1	15.00	15.00
16	Këpuce (nr 41 sezona dimer)	Copë	1	23.00	23.00
				Totali:	240.00


Specifikacion:Furnizim me Veshembathje per Institucionet e Komunes së Shtimes,IP' Albiona Asllani-Shtime




NR	PËRSHKRIMI	NJISIA	SASIA	ÇMIMI	TOTALI
1	Jorgana për fëmijë (të bardhë me mbushje pambuku- me standarde për fëmijë, të cilët lahen në lavatriçe në 90°C) modeli dhe dimensionet merren në I.P	copë	15	6.00	90.00
2	Jastëk për fëmijë (të bardhë me mbushje pambuku- me standarde për fëmijë) 50cmx35cm	copë	20	3.00	60.00
3	Batanije për ndërrimin e pelenave për fëmijë, materiali frutir sipër dhe llastek përfundi e cila nuk e lëshon ujin dhe e cila zihet në lavatriçe 90° C (60x100)	copë	16	5.00	80.00
4	Kocele e bardhë e dyanshme me lidhëse, me mbishkrim të institucionit- kualitet (material që pastrohet në 90° C dhe hekuroset lehtë)	copë	4	5.00	20.00
5	Kocele e kaltër qielli e dyanshme me lidhëse, me mbishkrim të institucionit- kualitet (material që pastrohet në 90° C dhe hekuroset lehtë)	copë	4	5.00	20.00
6	Peqëta për gota kualitet (të bardha me vija të kaltërta, material që pastrohet në 90° C dhe hekuroset lehtë)	copë	10	1.00	10.00
7	Peshqira për duar kualitet 70 x 50cm të bardhë (material që pastrohet në 90° C)	copë	44	3.00	132.00
8	Mantil (jelek) ngjyrë vishne pa krahë, me mbishkrim të institucionit- kualitet (material që pastrohet në 60° C dhe hekuroset lehtë)	copë	4	10.00	40.00
9	Komplete ngjyrë vishne/ pantolla dhe bluzë, me mbishkrim të institucionit- kualitet (material që pastrohet në 60° C dhe hekuroset lehtë)	copë	2	18.00	36.00
Operatori ekonomik i cili shpërblehet me kontratë, është i obliguar të bëjë furnizimin me veshmbathje pas përzgjedhjes së veshmbathjeve nga ana e stafit të I.P "Albiona Asllani"- Shtime(kualitetin, madhësinë, numrat, ngjyrat dhe cilësinë), në të kundërtën nuk do të pranohet malli.					
Totali:					488.00

REKAPITULIM

Nr	Pozicioni	Çmimi
1	Furnizim me Veshmbathje per Institucionet e Komunës së Shtimes- Drejtora për Sherbime Publike	382.00
2	Furnizim me Veshmbathje per Institucionet e Komunës së Shtimes,Drejtora për Ekonomi Zhvillim-Njësia e Pylltarisë	240.00
3	Furnizim me Veshmbathje per Institucionet e Komunës së Shtimes,IP"Albiona Asllani-Shtime	488.00
Gjithsejt Totali		1.110,00



Emri i Kompanisë	NPT "ELLCANA"
Adresa e Plote	Rr. Ali Sokoli nr.45 Rahovec
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	Mizahir Cana
Pozita	Pronar
Nënshkrimi	
Data	17.06.2020
Vula	

